




Aftësitë bazë

21st CENTURY SCHOOLS

**MËSIMI I MENDIMIT KRITIK DHE
ZGJIDHJES PROBLEMORE**

Burimet e pjesëmarrësve

www.britishcouncil.org

përmbajtje:

1. HYRJE NË PROGRAM	5
1.1 Rezultatet e të nxënit	5
1.2 Përmbledhje dhe koncepte	5
1.3 Rreth MKZP-së	6
1.4 Vlerësimi formues dhe përmbledhës në klasë	7
1.5 Fjalor i termave	8
2. PROGRAMI I TRAJNIMIT	9
2.1 Dita e parë	9
SESSIONI 1: RRETH MENDIMIT KRITIK	9
SESSIONI 2: MJEDISI I TË NXËNIT PËR MKZP-në	13
SESSIONI 3: PYETJET JANË TË RËNDËSISHME	17
SESSIONI 4: PYETJET – PJESA 2	19
2.2 Dita e dytë	24
SESSIONI 1: DËSHMITË	24
SESSIONI 2: DËSHMITË – PJESA 2	30
SESSIONI 3: PERSPEKTIVAT E NDRYSHME	31
SESSIONI 4: STRATEGJITË DHE MJETET E MËSIMDHËNIES	33
2.3 Dita e tretë	37
SESSIONI 1: MICRO:BIT-i	37
SESSIONI 2: MICRO:BIT-i – PJESA 2	39
SESSIONI 3: REFLEKTIMI	40
PAS TRAJNIMIT	41
SESSIONI 4: PLANIFIKIMI I PROJEKTIT TË SHKOLLËS	43



1 HYRJE NË PROGRAM

1.1 Rezultatet e të nxënit

Gjatë këtij programi ju:

1	2	3	4	5
Do të përfitoni njohuri teorike bazë të Mendimit Kritik dhe Zgjidhjes problemore (MKZP), të njohura në nivel ndërkombëtar.	Do të analizoni dëshmi të dokumentuara për mënyrën se si MKZP-ja mund të mësohet dhe vlerësohet .	Do të shihni shembuj praktikë mbi mënyrën e zhvillimit të MKZP-së në shkollat tuaja.	Do të identifikoni mundësitë për ti zhvilluar aftësitë e MKZP-së brenda shkollës suaj .	Do të zhvillonit teknika të udhëheqjes, menaxhimit të projekteve dhe të vetëvlerësimit për ta përfshirë MKZP-në në praktikën tuaj.

Këto rezultate të nxëni lidhen me praktikën e mësimdhënies që përdorni ju dhe kolegët tuaj në shkollë, brenda dhe përtej mësimdhënies së kurrikulës kombëtare.

1.2 Përmbledhje dhe koncepte

Struktura e paketës së trajnimit mbështetet në parimet e mëposhtme:

- MKZP-ja duhet të mësohet në kontekstin e lëndës
- përvojat e nxënësve shërbejnë si një mënyrë të menduari për konceptet komplekse
- mësuesi duhet t'i bëjë të qarta strategjitë e MKZP-së
- për të përmirësuar aftësitë e MKZP-së, nxënësit duhet të praktikohen vazhdimisht.

Programi do të fokusohet në pesë karakteristikat kyçe të MKZP-së:

- zgjidhjen problemore dhe pyetje të pazakonta
- shqyrtimin e perspektivave të ndryshme për çështjet
- vlerësimin e dëshmimeve dhe këndvështrimet e ndryshme
- kuptimin e strukturave të ndërlikuara të çështjeve.

DITA 1	DITA 2	DITA 3
Sesioni 1 Hyrje në Mendimin kritik dhe zgjidhjen problemore (MKZP)	Sesioni 1 Dëshmitë – pjesa 1	Sesioni 1 Micro:bit-i dhe zgjidhja e problemeve
Sesioni 2 Mjedisi i të nxënit për zhvillimin e MKZP-së	Sesioni 2 Dëshmitë – pjesa 2	Sesioni 2 Micro:bit-i – Pjesa 2
Sesioni 3 Pyetjet që e mbështesin MKZP-në	Sesioni 3 Perspektivat e ndryshme	Sesioni 3 Reflektimi dhe planifikimi për hulumtimin e mëtejshëm të MKZP-së
Sesioni 4 Pyetjet – pjesa 2	Sesioni 4 Strategjitë për zgjidhjen problemore	Sesioni 4 Planifikimi i projekteve shkollore

1.3 Rreth MKZP-së

Mendimi kritik ka qenë një shprehje në modë në fushën arsimore për shumë vite. Me gjithë rëndësinë e aftësive të të menduarit të nivelit të lartë, sipas hulumtimeve pjesa më e madhe e programeve të mendimit kritik ka arritur përfitime modeste. Para se ta fillojmë këtë program, do t'ju rekomandonim të lexoni artikullin *Critical Thinking: Why Is It So Hard To Teach?*¹ Ia vlen të reflektojmë në lidhje me konkluzionet kryesore të Willingham-it dhe ndikimet që ato kanë:

Programet e veçanta nuk funksionojnë. Të menduarit në mënyrë kritike duhet të mësohet në kontekstin e lëndës.

Përfshirja: Mundohuni ta përshtatni përmbajtjen e këtij programi mësimor bazuar në lëndën që jepni. Punoni me kolegët që japin mësim grup moshës së njëjtë dhe mendoni për rëndësinë dhe përshtatshmërinë e MKZP-së për lëndët tuaja..

Mendimi kritik nuk është i përshtatshëm vetëm për nxënësit më të avancuar.

Përfshirja: Të gjithë nxënësit janë të aftë për mendim kritik. Është shumë e rëndësishme të kuptojmë se kur duhet të përdoren strategjitë e mendimit kritik dhe si ta arrijmë këtë me sukses.

Përvojat e nxënësve shërbejnë si një mënyrë të menduari për konceptet komplekse.

Përfshirja: Shqyrtoni shembujt e përdorur në këto materiale dhe reflektoni nëse ato janë të përshtatshme për audiencën tuaj. Nëse nuk janë, përdorni shembuj të tjerë që lidhen më mirë me përvojat e pjesëmarrësve tuaj, si një mënyrë për të menduar në mënyrë kritike për konceptet komplekse.

¹ Willingham, DT (2007) *Critical Thinking: Why Is It So Hard To Teach?* [Mendimi kritik: Pse është kaq e vështirë t'ua mësosh të tjerëve?] American Federation of Teachers [Federata Amerikane e Mësimdhënësve], Periodicals, Summer 2007. Mund ta gjeni në: www.aft.org/sites/default/files/periodicals/Crit_Thinking.pdf

Për t'ju mësuar nxënësve strategjitë e mendimit kritik, shprehini ato qartë dhe praktikojini.

Përfshirja: Shpjegoni qartë strategjitë e ndryshme të MKZP-së. Këtë mund ta bëni duke menduar me zë: 'Në 15 minutat e ardhshëm, le ta praktikojmë se si mund ta shqyrtojmë këtë çështje nga disa perspektiva. Do t'ju shtroj pyetje, duke ju nxitur të merrni parasysh perspektiva të ndryshme.' Po ashtu, dua që ta kuptoni se MKZP-ja nuk mësohet shpejt. Kërkon shumë praktikë – jo ditë apo muaj, por me shumë gjasa edhe vite.

1.4 Vlerësimi formues dhe përmbledhës në klasë

Vlerësimi efikas do ta përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve. Dylan Wiliam nga hulumtimet e bëra ka rishikuar dëshmitë për vlerësimin formues dhe sugjeron pesë hapa për mësuesit:

1. Sqarimin, shkëmbimin dhe kuptimin e synimeve të mësimi (qëllimet/rezultate të nxënësve dhe kritereve për sukses
2. Nxitjen e aktiviteteve në klasë që nxjerrin në pah dëshmi të nxënësve
3. Paraqitjen e përfundimeve (feedback-ut) që nxisin aftësitë e nxënësve
4. Sjellja e nxënësve si burim mësimor për njëri tjetrin
5. Sjellja e nxënësve si zotërues të nxënies së tyre.²

VLERËSIMI FORMUES

Qëllimi i vlerësimit formues është monitorimi i nxënies së nxënësve për të konstatuar sa kanë kuptuar dhe për të paraqitur feedback të vazhdueshëm, në mënyrë që ju të mund ta përmirësoni mësimdhënien tuaj dhe nxënësit të mund ta përmirësojnë nxënien e tyre.

Ne do të sugjeronim metodat e vlerësimit formues në vijim:

- Përdorimi i pyetjeve sqaruese: shtroni pyetje për të konstatuar si e keni kuptuar ju të menduarit e tyre.
- Dëgjimi: nxisni nxënësit t'ju shpjegojnë si e dinë që diçka është e vërtetë. Mundohuni që nga shpjegimet e tyre të konstatooni nëse kanë ide të gabuara.
- Biseda me njëri tjetrin: nxisni nxënësit të diskutojnë me njëri tjetrin për mënyrën se si do ta zgjidhnin një çështje të caktuar. Si mësues, ju duhet të ecni nëpër klasë dhe të dëgjoni bisedat e tyre.
- Vizatimi: kërkon nga nxënësit që në vend që ta shkruajnë, ta vizatojnë çfarë kuptojnë.
- Vlerësimi përmbledhës: qëllimi i vlerësimit përmbledhës është vlerësimi që bëhet në fund për të nxënësve, duke e krahasuar atë kundrejt një standardi.

² Wiliam, D. (2010) „The Role of Formative Assessment in Effective Learning Environments”[Roli i vlerësimit formues në mjediset frytdhënëse të nxënies], in Dumont H, Istance, D, Benavides, F (ed) The Nature of Learning: Using Research to Inspire Practice [Natyra e të nxënësve: Përdorimi i hulumtimit për të frymëzuar praktikën], OECD Centre for Educational Research and Innovation [Qendra e OECD-së për hulumtime arsimore dhe inovacion], pp 135–159. Mund të gjendet në: www.educ.ethz.ch/pro/litil/oecdbuch.pdf

PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT TË SHKOLLËS

Shkruani një përmbledhje ku të pasqyroni procesin e përfshirjes së MKZP-së në mësimdhënie dhe të nxënësve, duke iu përgjigjur pyetjeve në vijim:

- Cili ishte objektivi i projektit të shkollës sime?
- Cilat qasje për përmirësimin e MKZP-së i kam provuar?
- Deri në çfarë mase këto qasje ishin të suksesshme? Pse?
- Çfarë do të bëja ndryshe?

1.5 Fjalor i termave

Mendimi kritik. Të menduarit në mënyrë të pavarur që prodhon ide të reja, origjinale dhe zgjidh probleme.

Reflektimi kritik për përvojat dhe proceset e të nxënësve dhe marrja e vendimeve efektive duke i shmangur grackat e zakonshme, për shembull shqyrtimi vetëm nga një këndvështrim i një çështjeje, vënia në dyshim e atyre dëshmive që nuk janë në pajtim me idetë tuaja, arsyetimi i bazuar në pasion e jo në logjikë, mosmbështetja e deklaratave me dëshmi.

Zgjidhja e problemeve. Sa herë që keni një qëllim që është bllokuar për ndonjë arsye – mungesa e burimeve, mungesa e informacioneve e kështu me radhë – ju keni një problem. Çfarëdo që të bëni me synimin për ta arritur qëllimin tuaj konsiderohet si zgjidhje e problemit.³

Problemet e zakonshme. Problemet e zakonshme mund të zgjidhen duke përdorur metoda të njohura për nxënësit, duke i përsëritur hap pas hapi metodat e mësuara paraprakisht.⁴

Problemet e pazakonshme. Problemet e pazakonshme janë probleme për ‘të cilat nuk ka qasje ose mënyra të mëparshme të aplikuara me sukses ose të sugjeruara në mënyrë të qartë nga detyra, udhëzimet e detyrës ose një shembull i zgjidhur’.⁵

3 Kahney, H. (1993) Problem solving: *Current Issues*. (PZgjidhja e problemeve: çështje aktuale). Buckingham: Open University Press

4 Woodward, J., Beckmann, S., Driscoll, M., Franke, M., Herzig, P., Jitendra, A., Koedinger, KR. and Ogbuehi, P. (2012) *Improving Mathematical Problem Solving in Grades 4 through 8: A Practice Guide* [Përmirësimi i zgjidhjes së problemeve matematikore në klasat nga e 4-ta deri në 8-ën: Udhëzues praktik] (NCEE 2012-4055). Washington, DC: National Center for Education Evaluation and Regional Assistance [Vlerësimi dhe asistenca rajonale], Institute of Education Sciences, US Department of Education. Mund ta gjeni në: http://ies.ed.gov/ncee/wwc/publications_reviews.aspx#pubsearch

5 Ibid.

2 PROGRAMI I TRAJNIMIT

2.1 Dita e parë

Qëllimi kryesor i ditës së parë është që të gjithë të kuptojnë rezultate e pritshme të trajnimit, konceptet kryesore dhe treguesit e suksesit në përmirësimin e aftësive të MKZP-së. Gjithashtu, pjesëmarrësit do të praktikojnë aftësitë e tyre në formulimin e pyetjeve që ndihmojnë zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit.

SESIONET

Sesioni 1 | Hyrje në mendimin kritik dhe zgjidhjen problemore (MKZP)

Sesioni 2 | Mjedisi i të nxënit për zhvillimin e MKZP-së

Sesioni 3 | Pyetjet që e mbështesin MKZP-në

Sesioni 4 | Pyetjet – pjesa 2

SESIONI 1: RRETH MENDIMIT KRITIK

Rezultatet e të nxënit

Pjesëmarrësit do të:

- njihen më mirë me njëri-tjetrin
- identifikojnë karakteristikat kryesore të mendimit kritik
- krahasojnë përkufizimet me praktikën e tanishme në arsim
- përcaktojnë qëllime personale për nxënie.


PREZANTIMI

PREZANTONI PERSONIN AFËR JUSH

EMRI:	
LËNDA QË AI/AJO JEP:	
VITET NË MËSIMDHËNIE:	
NJË FAKT INTERESANT:	

■ MENDIMTARI KRITIK

A jeni mendimtar kritik? Si e dini këtë? Cili është dallimi në mes mendimtarit kritik dhe personave që nuk mendojnë në mënyrë kritike? Mendoni për situatat e mundshme në të cilat na duhet mendimi kritik (vendimmarrja, leximi i teksteve informuese, përdorimi i medias, zgjidhja problemore, vlerësimi, gjykimi, formimi i opinioneve...), dhe i shkruani ato në pjesën e mesit. Identifikoni dallimet në mes mendimtarit kritik dhe jo mendimtarit kritik, dhe i shkruani ato në kutitë anash.



■ ZOTËSITË QË LIDHEN ME MENDIMIN KRITIK

Mendimtarët kritikë:

1. Shtrojnë pyetje të të menduarit të nivelit të lartë
2. Mbledhin fakte nga burime të besueshme
3. Shprehin mendimin e tyre duke përdorur argumente
4. Marrin parasysh perspektivat e tjera
5. Zgjidhin probleme
6. Kuptojnë shkaqet dhe pasojat
7. Mendojnë në mënyrë të pavarur
8. Marrin vendime bazuar në dëshmi.

Diskutoni pyetjet në vijim në një grup të vogël:

- Pse është e rëndësishme kjo aftësi për nxënësit?
- Kur mund ta përdorin nxënësit atë në shkollë/jetë?
- Nga cilat njohuri, aftësi dhe vlera/bindje përbëhet kjo zotësi?
- Tregojini nxënësve një shembull të mësimit të kësaj zotësie, të cilën ju jeni duke e aplikuar aktualisht.

■ AKTIVITETI: PËRKUFIZIMET

Ndonëse mendimi kritik ka qenë temë e njohur në fushën arsim për një kohë të gjatë, ende nuk është rënë dakord për përkufizimin e tij. Në pjesën tjetër të sesionit do të hulumtojmë aspektet kyçe të përkufizimit.

Përkufizimi nga John Dewey:

Shqyrtimi aktiv, i vazhdueshëm dhe i kujdesshëm i një bindjeje ose forme të supozuar të dijes, duke u bazuar në argumentet që e mbështesin atë dhe përfundimet e mëtejshme drejt të cilave zhvillohet.⁶

Përkufizimi aktual nga British Council

Të menduarit në mënyrë të pavarur që paraqet ide të reja, origjinale dhe zgjidh probleme. Reflektimi në mënyrë kritike mbi përvojat dhe proceset e të nxënit dhe marrja e vendimeve frytdhënëse.

Cilat janë karakteristikat kryesore të këtyre përkufizimeve?

Nxirrni fjalët kyçe dhe diskutojini ato – parafrazoni karakteristikat kyçe me fjalët tuaja.

Mundohuni të gjeni një karakteristikë të kundërt.

Përkufizimi klasik nga Dewey

PËRKUFIZIMI – KARAKTERISTIKAT	KARAKTERISTIKAT E KUNDËRTA
mendimi kritik si proces aktiv	
i vazhdueshëm dhe i kujdesshëm	
vëmendje në arsytet për të besuar diçka	
nënkuptimet e mëtejshme të bindjeve tona	

⁶ Dewey, J. (1909) *Moral Principles in Education* (Parimet morale në arsim), Cambridge, Mass. Riverside Press.

Përkufizimi aktual i British Council

PËRKUFIZIMI – KARAKTERISTIKAT	KARAKTERISTIKAT E KUNDËRTA
të menduarit në mënyrë të pavarur	
gjenerimi i ideve të reja dhe origjinale	
marrja e vendimeve frytdhënëse	

■ ÇFARË DUA TË DI?

Temat e trajnimit:

1. Mjedisi i klasës për MKZP-në
2. Pyetjet
3. Dëshmitë
4. Perspektivat e ndryshme
5. Strategjitë për zgjidhjen e problemeve
6. Micro:bit-i

UNË DIJA/UNË MËSOVA	DO TË DOJA TË DIJA – PYETJET DHE PRITSHMËRITË

SESIONI 2: MJEDISI I TË NXËNIT PËR MKZP-në

Zhvillimi i aftësive të mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore kërkon mësues shumë të shkathët, në gjendje që të krijojnë një mjedis nxënie të sigurt, mbështetës dhe sfidues, ku nxënësit të ndihen të lirë dhe të inkurajuar, të mendojnë, shtrojnë pyetje, hulumtojnë, punojnë në grupe, pa pasur frikën se po gabojnë.

Rezultatet e të nxënit

Pjesëmarrësit do të:

- identifikojnë parakushtet kryesore për përmirësimin e aftësive të MKZP-së së nxënësve
- krijojnë rregulla për klasën në të cilën nxitet zhvillimi i MKZP-së
- përdorin tregues për vetëvlerësimin për praktikën në klasë.

■ ÇFARË NUK DUHET TË BËJMË

Diskutoni: Çfarë ju ka penguar ose dekurajuar ndonjëherë për të “menduar” dhe/ose shprehur publikisht opinionin tuaj? Ndoshta keni vuajtur pasojat për atë që keni bërë ose keni përvoja të tjera negative? Tregoni edhe përvojat pozitive. Çfarë kanë bërë mësuesit ose të rriturit e tjerë për ta mbështetur MKZP-në?

Pas një diskutimi të shkurtër, bëni një listë të detajuar të të gjitha gjërave që e “vrasin” të menduarit, sidomos mendimin kritik në klasa dhe në shkolla, dhe diskutoni pse ndodh kjo.

ÇFARË “E VRET” MENDIMIN KRITIK?

Mendoni për:

- Strategjitë e mësimdhënies
- Klimën në klasë
- Kurrikulën
- Kulturën dhe bindjet...

■ ZGJIDHJET – ÇFARË DUHET TË BËJMË

Shikoni listën dhe mendoni për zgjidhjet e mundshme. Mendoni për mjedisin e klasës në të cilin nxënësit do të inkurajoheshin dhe përkraheshin për të menduar në mënyrë kritike dhe për të zgjidhur probleme. Pranoni faktin se ka edhe pengesa.

Çfarë mund të bëjmë ne si mësues dhe çfarë duhet të presim nga nxënësit tanë?

KLASA NË TË CILËN NXISIM ZHVILLIMIN E MENDIMIT KRITIK DHE ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE

MËSUESI DUHET	NXËNËSIT DUHET

TREGUESIT PËR PRAKTIKËN E MËSIMDHËNIES

Tani të mendojmë për mënyrat e vëzhgimit të këtyre praktikave në klasë dhe mënyrat për t'i përshkruar ato.

A janë treguesit të qartë, të kuptueshëm, të vëzhgueshëm? A pajtoheni me ata? A kemi harruar gjë?

Kush mund t'i përdorë, si dhe pse?

TREGUESIT PËR PRAKTIKIMIN E MKZP-SË NË KLASË

VETËVLERËSIMI I MËSUESIT:	FILLIM I MIRË	DERI DIKU	SHPESH IA DALIM ME SUKSES	JEMI KLASË E MKZP-së
MJEDISI I TË NXËNIT				
Përkrahin nxënësit që të shprehin lirshëm mendimet e tyre pa pasur frikën se po gabojnë.				
Inkurajojnë nxënësit të pyesin dhe kërkojnë ndihmë kur iu duhet.				
Tregojnë durim duke iu dhënë nxënësve kohë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur pyetjes.				
Inkurajojnë shprehjen e mendimeve dhe qëndrimeve të ndryshme midis nxënësve me një ton miqësor dhe që tregojnë respekt.				
Krijojnë kushte për bashkëpunim dhe shkëmbim (puna në çift ose grupe të vogla, shkëmbimi).				

Përkrahin interesimet e nxënësit në tema të tjera, edhe kur ato nuk janë pjesë e kurrikulës ose mësimit.				
Ndihmojnë nxënësit ta lidhin atë që mësojnë me përvojën e tyre të mëparshme dhe me problemet e çështjet e jetës së përditshme.				
PYETJET				
Përpilojnë pyetje që e mbështesin MKZP-në si pjesë të planifikimit të orës mësimore.				
Shtrojnë pyetje që kërkojnë mendim të thellë, hulumtime, analizë dhe konkluzione.				
Mësojnë fëmijët si të formulojnë pyetje të mira.				
Pyesin shpesh nxënësit: Çfarë mendon ti? Si mund ta kuptojmë? Etj.				
Mundohen të ndjekin linjën e mendimit të një nxënësi që ka dhënë një përgjigje të gabuar ose të pa arsyetuar.				
Bëjnë pyetje të cilat i ndihmojnë nxënësit të shqyrtojnë procesin e tyre të të menduarit – Si e kuptove? Si e di? Pse mendon se kjo...? (Pyetje Sokratike).				
DËSHMITË				
Inkurajojnë nxënësit të mbledhin informacione dhe dëshmi nga burime të ndryshme.				
Mësojnë nxënësit si të gjejnë burime të besueshme të informacioneve dhe të dhënave.				
Kërkojnë që nxënësit ta mbështesin mendimin e tyre me dëshmi dhe argumente.				
Ndihmojnë nxënësit të kuptojnë se ata mund ta ndryshojnë mendimin e tyre kur prezantohen me dëshmi të besueshme, dhe nuk është e rëndësishme nëse kanë të drejtë apo jo, por të gjendet zgjidhja më e mirë.				

PERSPEKTIVAT E TJERA				
Presin nga nxënësit të marrin parasysh mendime dhe burime të ndryshme të informacionit.				
Nxisin nxënësit të ndajnë në mënyrë të lirshme pikëpamjet dhe mendimet e ndryshme.				
I japin nxënësve mundësinë që t'i shikojnë gjërat nga perspektiva e personave ose grupeve të ndryshme.				
Nxisin nxënësit të marrin vendime duke marrë parasysh nevojat e të tjerëve.				
ZGJIDHJA PROBLEMORE				
Ndihmojnë nxënësit të analizojnë shkaqet dhe pasojat e fenomeneve dhe problemeve të caktuara, me qëllim që të përcaktohen rezultate të nxëni dhe kritere të qarta të suksesit.				
Nxisin nxënësit të hulumtojnë të dhënat dhe të fitojnë njohuri të mjaftueshme për një problem të caktuar.				
Shtrojnë pyetje dhe ofrojnë strategji të ndryshme, të cilat i shtyjnë fëmijët drejt gjetjes së zgjidhjes së tyre.				
Inkurajojnë ide krijuese dhe të menduarit "jashtë kutisë".				
Ndihmojnë nxënësit të testojnë idetë e tyre për zgjidhje të mundshme dhe të fillojnë nga e para nëse është e nevojshme (mësimi nga gabimet).				

Jam i/e mirë në: _____

Do të doja të mësoja më shumë për: _____

Në të ardhmen do të doja të punoja më shumë në: _____

SESIONI 3: PYETJET JANË TË RËNDËSISHME

Rezultatet e të nxënit


Pjesëmarrësit do të:

- mbledhin dhe organizojnë të dhëna
- krijojnë dhe analizojnë lloje të ndryshme pyetjesh.

HARTA MENDORE

Harta mendore është një diagram që përdoret për të organizuar informacionin në mënyrë vizuale. Në hartën mendore ka hierarki dhe paraqiten marrëdhëniet mes pjesëve të tërësisë. Zakonisht kjo krijohet rreth një koncepti të vetëm, i paraqitur si imazh në qendër të një flete të zbrazët, të cilës i shtohen përfaqësimet e ndërlidhura të ideve si imazhe, fjalë dhe pjesë të fjalëve. Idetë kryesore lidhen drejtpërdrejt me konceptin qendror ndërsa idetë tjera degëzohen nga idetë kryesore.

Shembull – përpiloni hartë mendore për hartën mendore⁷



⁷ <https://selfdesigninstitute.org/mindmapping-and-selfdesign/>

Mendoni-ndahuni në çifte-prezantoni (*think-pair-share*) jështë një metodë që i lejon nxënësve të mendojnë në mënyrë individuale dhe në një grup të vogël përpara se t'ju kërkohet t'ju përgjigjen pyetjeve para gjithë klasës. Metoda ka katër hapa. Së pari, grupet dëgjojnë pyetjen që e bën mësuesi. Së dyti, nxënësve veç e veç u jepet kohë për të menduar dhe pastaj për të shkruar përgjigjet e tyre. Së treti, dyshet e nxënësve i lexojnë dhe diskutojnë përgjigjet e tyre. Në fund, mësuesi thërret disa nxënës për të ndarë mendimet dhe idetë e tyre me gjithë klasën.

■ GJENERIMI I PYETJEVE

Mbledhja dhe organizimi i informacionit dhe i të dhënave, si mënyrë për të fituar njohuri për një temë të caktuar, është vetëm fillimi i procesit. Nxënia e vërtetë fillon me shtrimin e pyetjeve të mira.

Si hap i parë, gjeneroni sa më shumë pyetje që është e mundur, duke përdorur hartën mendore:

1. Informacionin që keni shndërrojeni në pyetje.
2. Shtroni pyetje të reja: Çfarë do të dëshironit të dini?
3. Mendoni për pyetjet për të cilat nxënësit duhet të hulumtojnë dhe hetojnë më shumë, të zgjidhin probleme ose të dalin me ide ose zgjidhje origjinale.

■ ANALIZIMI I PYETJEVE

Tri nivelet e pyetjeve:

Niveli i parë: ROBOTËT

Pyetje që mund të marrin përgjigje thjesht duke i parë në libër ose duke i hulumtuar në internet. Fakte të thjeshta - një përgjigje e saktë.
Informacioni duhet të kujtohet dhe kuptohet.
Kush, çfarë, ku, kur, si?

Niveli i dytë: DETEKTIVËT

Pyetjet që kërkojnë më shumë informacion që gjendet në disa burime ose pjesë të tekstit/librit, dhe pastaj ndërlidhjen e tyre dhe arrijnë në një përfundim.
Kërkohet lidhja, analizimi, krahasimi, ballafaqimi...që gjithashtu kanë përgjigje të sakta.
Çfarë mund të shkaktojë ...?
Në çfarë ngjasojnë/dallojnë ato ...?
Çfarë tregon shembulli për ...?
Si mund ta lidhni ...?

Niveli i tretë: HULUMTUESIT

Pyetjet që kërkojnë hetime, hulumtime dhe eksperimentime të mëtejme (nuk ka përgjigje të qartë).
Kërkohet krijim, dalje me përfundime, vlerësim, vërtetim.
Çfarë do të ndodhte nëse ...?
Si do të mundeshim ne ...?
Pse unë duhet...?
Çfarë mendoni ...?

SESIONI 4: PYETJET – PJESA 2

Është e rëndësishme që nxënësit të mësojnë se si të bëjnë pyetje të niveleve të larta. Kjo i ndihmon t'i thellojnë njohuritë e tyre dhe të krijojnë lidhje me materialin e prezantuar, dhe nga ana tjetër i përgatit për hetimin.

Rezultatet e të nxënit

Pjesëmarrësit do të:

- vlerësojnë dhe përmirësojnë pyetjet e tyre për të reflektuar shkathtësi superiore të të menduarit
- përdorin taksonomitë e Bloom-it dhe Costa-s
- përdorin mjete të ndryshme për t'i përmirësuar aftësitë e nxënësve në shtrimin e pyetjeve.

■ TAKSONOMIA E BLOOM-it DHE TRI NIVELET E MENDIMIT TË COSTA-s

Tri nivelet e mendimit është taksonomi e të menduarit të nivelit të lartë dhe të ulët, e zhvilluar nga Arthur L. Costa. Tri shtresat ose nivelet mund të përputhen përgjithësisht me gjashtë nivelet e Taksonomisë së Bloom-it, por kjo do të ishte më e përshtatshme për nxënësit e shkollës fillore dhe do t'i ndihmonte ata të formulonin pyetje dhe të vlerësonin nxënien e tyre.

Tri nivelet e Costa-s për shtrimin e pyetjeve janë:

Niveli 1: Mbledhja e informacionit (të menduarit e nivelit të ulët)

- Përgjigja mund të gjendet në tekst (në mënyrë direkte ose indirekte)
- Shumë konkrete dhe ka të bëjë vetëm me tekstin
- Kërkon fakte për atë çfarë është dëgjuar ose lexuar
- Informacioni kujtohet në mënyrën/formën e njëjtë si është dëgjuar.

Përkufizo — përcaktimi i kuptimit të

Përshkruaj — përshkrimi ose prezantimi me fjalë

Identifiko — përcaktimi i identitetit të

Listo — një seri e fjalëve ose numrave

Emërto — referimi ose identifikimi me emër

Vrojto — të shohësh ose të ndjesh

Përsërit — përsëritja fjalë për fjalë

Shqyrto — ekzaminimi nga afër.

Niveli 2: Përpunimi i informacionit

- Përgjigja mund të nxirret nga teksti
- Ndonëse më abstrakte se një pyetje e nivelit të parë, ka të bëjë vetëm me tekstin
- Informacioni mund të ndahet në disa pjesë

- Përfshin shqyrtimin në hollësi, analizimin e motiveve ose shkaqeve, duke nxjerrë konkluzione, gjetur informacione për të mbështetur përgjithësimet ose vendim marrjen
- Pyetjet i kombinojnë informacionet në një formë të re.

Analizo — të bëhet analizë, shqyrtim i një gjëje për të mësuar pjesët e saj

Krahaso — të shqyrtohet për ngjashmëri dhe dallime

Ballafaqo — të tregohen dallimet pas krahasimit

Grupo — mbledhja në grupe

Konkludo — nxjerrja si konkluzion nga faktet ose pohimet

Rendit — rendi kronologjik i ngjarjeve

Sintetizo — kombinimi i pjesëve ose elementeve në një tërësi.

Niveli 3: Aplikimi i informacionit (të menduarit e nivelit të lartë)

- Përgjigja shkon përtej tekstit
- Është abstrakte dhe nuk ka të bëjë me tekstin
- Kërkon që nga informacioni të jepen mendime
- Jep opinione për çështjet, gjykon besueshmërinë e ideve ose produkteve të tjera dhe arsyeton opinionet dhe idetë.

Apliko — vëre në praktikë

Vlerëso — çmoje, vlerësoje

Shtro hipotezë — të merret si hipotezë/supozim

Imagjino — të formohet një imazh mendor i diçkaje që nuk është e pranishme; hamendësim

Gjyko — të formohet një vlerësim për diçka; konkludim

Parashiko — të deklarohet paraprakisht

Spekulo — të mendohet ose pyetet rreth një çështje.

TAKSONOMIA E BLOOM-it dhe Nivelet e Costa-s për shtrimin e pyetjeve

Njohuritë (Mbajtja në mend)	Të kuptuarit (Kuptimi)	Aplikimi (Përdorimi)	Analiza (Analizimi)	Sinteza (Krijimi)	Vlerësimi (Vlerësimi)
Të nxënit e fakteve specifike, ideve, fjalorit; mbajtja mend/të kujtuarit e informacionit ose fakteve specifike	Aftësia për ta kuptuar domethënien e materialit; komunikuar njohuritë; kuptuar informacioni pa e lidhur atë me materialin tjetër	Aftësia për ta përdorur materialin e nxënë në situata të reja dhe konkrete; për të përdorur njohuritë e mësuara dhe interpretuar situatat e mëparshme	Aftësia për ta ndarë materialin në pjesët përbërëse dhe për ta kuptuar ndërlidhjen	Aftësia për të mbledhur bashkë pjesët për të formuar një tërësi; për të përdorur elementet në modele dhe marrëdhënie të reja	Aftësia për ta gjykuar vlerën e materialit për një qëllim të caktuar; gjykim bazohet në kriteret e dhëna
NIVELI I PARË MBLEDHJA E INFORMACIONIT Prezantimi i njohurive duke bërë si vijon:		NIVELI I DYTË PËRPUNIMI I INFORMACIONIT Praktikimi i njohurive të marra duke bërë si vijon:		NIVELI I TRETË APLIKIMI I INFORMACIONIT Tregon zotërim të njohurive të marra duke bërë si vijon:	
mbledhur, kopjuar, përkufizuar, përshkruar, gjetur, identifikuar, treguar, etiketuar, listuar, lokalizuar,	ndërruar, ndërlidhur, llogaritur, kategorizuar, ndryshuar, komunikuar, konvertuar, dalluar, zgjeruar,	përfutur, aplikuar, përdorur, mbledhur bashkë, kapitalizuar, ndërtuar, konsumuar, demonstruar, zhvilluar, diskutuar,	analizuar, rregulluar, ndarë në pjesë, kategorizuar, klasifikuar, krahasuar, ballafaquar, konkluduar, përcaktuar	ndërruar, ndërtuar, kombinuar, kompozuar, konstruktuar, krijuar, zhvilluar, vlerësuar, formuar një të re, gjeneruar, shtruar hipoteza, imagjinuar,	vlerësuar, diskutuar, çmuar, sfiduar, zgjidhur, konkluduar, kritikuar, debatuar, vendosur, mbrojtur, diskriminuar, diskutuar,

përputhur, emëruar, vëzhguar, cituar, lexuar, kujtuar, recituar, njohur, përsëritur, riprodhuar, thënë, përzgjedhur, klasifikuar, shqiptuar, deklaruar, nënvizuar, kush, kur, ku, çfarë	shpjeguar, informuar, përmbledhur, parafrazuar, riorganizuar, rindërtuar, ndërlidhur, ritreguar (me fjalët e veta), përmbledhur, treguar kuptimin e, përkthyer, kuptuar, verbalizuar, shkruar	eksperimentuar, formuluar, manipuluar, organizuar, lidhur, raportuar, kërkuar, shfaqur, zgjidhur problemet e reja, treguar pasojat, provuar, përdorur, shfrytëzuar	paraqitur në diagram, diferencuar, diskutuar shkaqet, shqyrtuar në imtësi, dalluar, dhënë arsye, renditur, ndarë, radhitur, anketuar, veçuar, testuar, pse	përmirësuar, konkluduar, shpikur, modifikuar, planifikuar, parashikuar, prodhuar, propozuar, riorganizuar, rishikuar, rishikuar, thjeshtësuar, sintetizuar	nxjerrje konkluzionesh, edituar, vlerësuar, graduar, interpretuar, gjykuar, arsyetuar, prioritetizuar, renditur, vlerësuar, rekomanduar, refuzuar, përkrahur, vërtetuar
Çfarë është...? Si është...? Ku është...? Kur ndodhi _____? Si _____? Pse...? Si do ta përshkruanit...? Kur ? A ju kujtohet...? Si do ta tregonit...? A mund ta zgjidhni...? Kush ishin ...kryesore...? A mund t'i listoni tri...? Cilat...? Kush ishte...?	Si do ta klasifikoni tipin e...? A mund ta thoni ose interpretoni me fjalët tuaja? Si do ta riformulonit kuptimin...? Cilat fakte ose ide tregojnë...? Cila është ideja kryesore e...? Cilat deklarata e mbështesin...? A mund ta shpjegoni çfarë po ndodh, çfarë është menduar...? Çfarë mund të thoni për...? Cila është përgjigja më e mirë? Si do ta përmbledhni...?	Si do ta përdorni...? Çfarë shembuj mund të gjeni për të...? Si do ta zgjidhni _____ duke përdorur ato që keni mësuar...? Si do ta organizoni _____ për të treguar...? Si do ta tregoni atë që keni kuptuar? Çfarë qasje do të përdorni për të...? Si do ta aplikoni atë që keni mësuar për të zhvilluar...? Çfarë forme tjetër do të planifikoni për të...? Çfarë do të ndodhte sikur...? A mund t'i përdorni faktet për të...? Cilat elemente do të zgjidhni ti ndryshoni? Cilat fakte do ti zgjidhni për të treguar...? Çfarë pyetjesh do të shtroni në një intervistë me...?	Cilat janë pjesët e? Si lidhet _____ me ? Pse mendoni? Cila është tema? Cili është motivi ? A mund ti listoni pjesët? Çfarë përfundimi mund të arrini për...? Çfarë konkludimesh mund të nxirrni? Si do ta klasifikoni...? Si do ta kategorizoni...? A mund t'i identifikoni pjesët e ndryshme? Çfarë dëshmi mund të gjeni? Cila është lidhja midis...? A mund të bëni dallimin midis...? Cili është funksioni i...? Si do t'i vlerësoni rezultatet për...?	Çfarë faktesh mund të përpiloni? A mund të ndërtoni një model që do të ndryshonte...? A mund të mendoni një mënyrë origjinale për...? A mund të dizajnoni një ... për të ...? Pse të mos kompozohet një këngë për...? A shihni zgjidhje të mundshme për...? Nëse do të kishit qasje në të gjitha burimet, si do të merreshit me...? Si mund ta zhvillonit mënyrën tuaj për t'u marrë me...? Çfarë do të ndodhte nëse...? Sa mënyra mund ti...? A mund të krijoni përdorime të reja dhe të pazakonshme për...? A mund ta shkruani një recetë të re/ udhëzime për...? A mund ta përpiloni një propozim i cili...	A pajtoheni me veprimet? Me rezultatet? Cili është opinioni juaj për...? Si do ta vërtetoni...? Nuk pajtoheni? A mund ta vlerësoni vlerën ose rëndësinë e... ? A do të ishte më mirë sikur...? Pse ata (personazhi) e zgjedhën...? Çfarë do të Rekomandoni...? Si do ta vlerësoni...? Si do ta përcaktoni...? Çfarë zgjedhesh do të kishit bërë...? Cilat do të zgjidhni...? Si do ti prioritetizoni...? Çfarë gjykimi do të jepni për...? Bazuar në atë që dini, si do ta shpjegoni...? Çfarë informacionesh do të përdorni për ta përkrahur pikëpamjen...? Si do ta arsyetonit...? Çfarë të dhënash janë përdorur për të nxjerrë konkluzionin...? Pse ishte ky më i mirë se...? Si do ti prioritetizoni faktet...? Si do ti krahasoni idetë...?

■ AKTIVITETI 2: ANALIZIMI DHE PËRMIRËSIMI I PYETJEVE

Në kolonën e djathtë shënoni pyetjet sipas nivelit të kompleksitetit nga niveli 1 (niveli më pak kompleks) deri në nivelin 3, duke shtuar foljet e përshtatshme (konkludo, llogarit, analizo, krahaso ...) në kolonën e majtë.

FOLJA	PYETJA	NIVELI 1, 2 OSE 3
	Çfarë do të bënit nëse do t'ju duhej të jetonit pa ujë të rrjedhshëm?	
	Cilat janë gjërat që bëni gjatë ditës për të cilat nevojitet ujë? Sa ujë përdorni gjatë një dite?	
	Nëse nuk do të kishit ujë të rrjedhshëm në shtëpinë tuaj, ku do të shkonit për të marrë ujë? Ku do të bënit dush?	
	A është uji në pronësi të dikujt?	
	A mban njeriu një qëndrim të drejtë ndaj ujit?	
	Kush është përgjegjës për t'ju ofruar njerëzve burime si uji?	
	Çfarë ju vjen në mendje kur dëgjoni fjalën 'ujë'?	
	Çfarë shije ka uji?	
	Kur preferoni të pini ujë?	
	Jacques Cousteau ka thënë: "Uji dhe ajri, dy elementët themelore nga e cila varet e gjithë jeta, janë bërë kontejnerë globalë të mbeturinave." Çfarë mendoni për këtë thënie?	
	A mendoni se uji duhet të jetë falas?	
	A e blini ujin e ambalazhuar apo pini nga rubineti?	
	A konsumoni mjaftueshëm ujë çdo ditë?	
	A mendoni ndonjëherë se sa i çmuar është uji?	
	Cilat janë tre mbiemrat që do të përdornit për ta përshkruar ujin?	
	Isak Dinesen ka thënë: "Kura për çdo gjë është uji i kripur - djersa, lotët, ose deti." Çfarë mendoni për këtë thënie?	
	A ju pëlqen uji — pse dhe pse jo?	
	A shqetësoheni nëse do të ketë ujë në të ardhmen?	
	Si mendoni se do të ishte jeta sikur të mos kishte ujë të rrjedhshëm?	
	Çfarë mendoni për faktin se shumica e popullatës në botë nuk ka ujë të rrjedhshëm, megjithatë shtetet e pasura shpenzojnë miliarda në naftë, mallra të markës, turizëm, etj.?	
	Në vitin 1732, Thomas Fuller ka thënë: "Nuk ia dimë vlerën ujit derisa të thahet pusi." Çfarë mendoni për këtë thënie?	
	Cilat janë gjërat më të mira dhe më të këqija për ujin e rubinetit dhe ujin e ambalazhuar?	
	Si formohet uji?	
	Çfarë gjërash të ndryshme mund të bëni me ujë?	
	Çfarë dini për ujin?	
	Henry David Thoreau ka thënë: "Besoj se uji është pija e vetme për një njeri të mençur." Çfarë mendoni për këtë thënie?	

MATRICA E PYETJEVE⁹

Matrica e pyetjeve është një mjet që mund t'i ndihmojë nxënësit të mësojnë se si të shtrojnë pyetje të nivelit më të lartë. Paraqitni para pjesëmarrësve mjetin dhe pyetini ata se si mund ta përdorin në klasë.

MATRICA E PYETJEVE	ËSHTË KOHA E TASHME	ISHTË KOHA E SHKUAR	MUND MUNDËSI	DUHET OPINION	MUND PROBABILITET	DO TË PARASHIKIM	MUND IMAGJINATË
ÇFARË? NGJARJE							
KU? VEND							
KUR? KOHË							
CILA? ZGJEDHJE							
KUSH? PERSON							
PSE? ARSYE							
SI? KUPTIM							

Niveli i përgjithshëm i vështirësisë së pyetjes rritet në drejtim të shigjetës. Një pyetje që fillon me 'Çfarë është?' zakonisht është më e lehtë për t'u formuluar dhe përgjigjur se një pyetje që fillon me 'Si mund?'



⁹ Cooperative Learning & Higher-level Thinking: the Q-matrix (2006) (Të mësuarit bashkëpunues dhe të menduarit të nivelit të lartë), Wiederhold, Chuck W. in consultation with Spencer Kagan

2.2 Dita e dytë

Dita e dytë fokusohet në leximin dhe shkrimin kritik, duke përfshirë dallimin midis fakteve dhe opinioneve, duke i mbështetur pohimet me dëshmi dhe duke mësuar për llojet e dëshmimeve. Në ditët e sotme është shumë e rëndësishme që të ndihmohen nxënësit për të bërë dallimin midis argumentit, bindjes dhe propagandës. T'u mësosh nxënësve se si të përdorin dëshmitë, i jep mundësinë atyre të zhvillohen si qenie njerëzore të virtytshme, që kontrollojnë nxënien dhe vendim marrjen e tyre, të bëhen qytetarë të informuar dhe që nuk manipulohen lehtësisht.

Dita e dytë përbëhet nga katër sesione prej 90 minutash:

SESIONET	
Sesioni 1	Dëshmitë
Sesioni 2	Dëshmitë – pjesa 2
Sesioni 3	Perspektivat e ndryshme
Sesioni 4	Strategjitë dhe mjetet për MK-në

SESIONI 1: DËSHMITË

Dëshmitë janë të dhëna mbi të cilat dikush mund ta bazojë gjykimin ose vendimin e tij. Mbledhja dhe vlerësimi i dëshmimeve janë cilësi e rëndësishme e mendimit kritik. Zakonisht bëhen dy gabime. E para, njerëzit nganjëherë i japin pikëpamjet ose i marrin vendimet e tyre pa pasur dëshmi ose i bazojnë në dëshmi të gabuara. E dyta, ka një tendencë për të mos i marrë parasysh dëshmitë që janë në kundërshtim me pikëpamjet tona të mëparshme. Në dy sesionet në vijim, do të shqyrtojmë si t'i mësojmë nxënësit tanë për mbledhjen dhe vlerësimin e dëshmimeve.

Rezultatet e të nxënit

Pjesëmarrësit do të:

- bëjnë dallimin në mes fakteve dhe opinioneve
- bëjnë dallimin midis pohimit, dëshmisë dhe arsyes
- mbështesin pohimet e tyre me dëshmi
- analizojnë dhe vlerësojnë dëshmitë në media dhe në tekste informuese.

■ POHIMI, DËSHMITË DHE ARSYETIMI

Faktet dhe opinionet

Shkruani tri opinione dhe tri fakte për veten tuaj, pa ndonjë renditje të veçantë. Shkëmbeni shënimet me partnerin dhe kërkon nga ai/ajo të shënojnë secilën fjali ose pohim me **F** për Fakte dhe **O** për Opinione.

Kontrolloni saktësinë e tyre dhe diskutoni..

FAKTET	OPINIONET
1.	1.
2.	2.
3.	3.

Si mund t'i përkufizojmë faktet dhe opinionet dhe pse është e rëndësishme që nxënësit t'i dallojnë ato?

Fakti – Një fakt në përgjithësi i referohet një diçkaje që është e vërtetë dhe mund të verifikohet si e tillë. Pra, një fakt është diçka që mund të provohet se është e vërtetë.

Opinion – Një opinion i referohet një bindjeje personale. Lidhet me atë se si dikush ndihet për diçka. Të tjerët mund të pajtohen ose jo me një opinion, por ata nuk mund ta vërtetojnë ose përgënjeshtrojnë atë. Kjo e përkufizon atë si opinion.

Aftësia për ta bërë dallimin në mes faktit dhe opinionit i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre kritike dhe analitike. Është e rëndësishme që nxënësit gjithashtu të kuptojnë se gjërat jo gjithmonë janë ashtu si duken. Nganjëherë, shkrimtarët, qëllimisht ose jo, e paraqesin opinionin si fakt dhe anasjelltas. Prandaj është e rëndësishme që nxënësit të kuptojnë qartë se çfarë përbën fakt dhe opinion, dhe të praktikojnë dallimin midis tyre.

CILI ËSHTË OPINIONI JUAJ?

Një nga qëllimet e mësimi të mendimit kritik është përmirësimi i aftësive të nxënësve për të formuluar opinionin e tyre dhe për ta mbështetur atë me dëshmi të besueshme. Gjithashtu, duhet të kenë shumë raste për t'i praktikuar aftësitë e të kuptuarit të leximit, duke identifikuar pohimet, dëshminë dhe arsyetimin në tekst, fjalime, reklama...

	PO	JO	PSE? JEPNI DY DERI NË TRE ARSYE PËR OPINIONIN TUAJ
A duhet të ndalohen telefonat celularë në shkollë?			
A kanë nevojë fëmijët për detyra shtëpie?			
A e përmirëson teknologjia jetën tonë?			
A janë prindërit tej mase mbrojtës ndaj fëmijëve të tyre?			

Si e formulojmë opinionin tonë? Bazuar në çfarë? Çfarë mund të na shtyjë të ndryshojmë mendim?

■ POHIMI, DËSHMITË DHE ARSYETIMI

POHIMI: deklaratë për zgjidhjen e një problemi:

- Çfarë mendoni se dini ose besoni?
- Çfarë pohimi mund të jepni bazuar në të dhëna ose dëshmi të tjera?

DËSHMITË:

- Cilat dëshmi (të dhëna, hulumtime, citime...) mbështesin pohimin tuaj?
- A keni dëshmi të mjaftueshme?
- A ka dëshmi që mund të sugjerojnë të kundërtën?
- (sipas..., në tekstin/librin, autori na mëson...)

ARSYETIMI:

- Si e mbështet kjo dëshmi pohimin tuaj?
- Cilat parime ose koncepte shkencore keni përdorur për t'i dhënë kuptim të dhënave dhe dëshmive?
- (kjo tregon... sepse, kjo dëshmon, mund të nxjerrim përfundim...)

Kërkoni nga pjesëmarrësit që të zgjedhin një temë dhe të plotësojnë formularin në vijim:

POHIMI Cili është opinioni im për atë që duhet bërë?	
DËSHMITË Çfarë dëshmie duhet të ofroj për ta mbështetur pohimin tim. Dëshmia shpesh vjen në formë citimi, statistike/të dhëna, ose referencë e cituar, por mund të përfshijë edhe shembuj të fuqishëm ose krahasime.	
ARSYETIMI Si e mbështet kjo dëshmi pohimin tim? Shpjegon se pse ka rëndësi dëshmia. Informacioni juaj mund të jetë i vërtetë, por duhet të shpjegoni më tej se si kjo e vërteton atë që po thoni. Çfarë është domethënëse për dëshminë tuaj?	

Diskutoni edhe pyetjet në vijim:

- Si e dimë se dëshmitë janë nga burime të besueshme?
- Si mund t'i prezantojmë dëshmitë (rezultate të hulumtimit, grafik, ese, artikull, vëzhgim...)?

Aktiviteti për nxënësit: Uji

Mendoni një aktivitet për nxënësit që do ti ndihmonte ata të bënin dallimin midis Pohimit, Dëshmisë dhe Arsyetimit (PDA).

Shembuj (shkencë):

Nxënësit më të vegjël:

Pyetja: Si ndikon drita në rritjen e bimëve?	
Pohimi ynë: Bima që ka marrë më shumë dritë është rritur më shumë.	
Dëshmia jonë: Биљка која је била изложена светлости 24 Brenda 24 orëve me dritë bima jonë u rrit 20 cm. Bima me 12 orë dritë u rrit vetëm 8 cm.	Arsyetimi ynë për dëshminë: За раст и развој биљака потребна је Бимët kanë nevojë për dritë për t'u rritur dhe zhvilluar. Prandaj bima që kishte dritë 24 orë u rrit më shumë.

Nxënësit më të mëdhenj:

Pyetja: Çfarë iu duhet bimëve për t'u rritur?	
Pohimi ynë: Bimët kanë nevojë për ujë, dioksid karboni dhe dritë për t'u rritur.	
Dëshmia jonë: Mesatarisht, gjashtë bimët që kishin dritë të vazhdueshme, dioksid karboni dhe ujë, u rriten 20 cm; ato çelen gjashtë lule të verdha, pesëmbëdhjetë gjethe dhe të gjitha kishin ngjyrë jeshile të hapur. Mesatarisht, gjashtë bimët që kishin dritë 12 orë, dioksid karboni dhe sasi uji të kufizuar, u rriten 8 cm; ato çelen dy lule të verdha dhe kishin katër gjethe. Dy prej bimëve nuk çelën fare lule. Këto bimë ende kishin ngjyrën jeshile të hapur, por ishin më të vogla dhe me më pak lule dhe gjethe.	Arsyetimi ynë i dëshmisë: Fotosinteza është procesi gjatë të cilit pemët e gjelbra prodhojnë sheqer nga uji, dioksidi i karbonit dhe energjia e dritës. Prodhimi i sheqerit është qenësor për rritjen dhe zhvillimin e bimës. Prandaj bimët që kishin burim konstant uji, dioksid karboni dhe dritë u rritën më shumë.

Pyetjet nga lëndët e tjera:

- A mori personazhi (i librit) vendimin e duhur?
- Çfarë do të kishte ndodhur ndryshe, nëse...?
- Cili është këndvështrimi i autorit në këtë çështje?

Pyetja:

Cili është filmi më i mirë për fëmijë që keni parë ndonjëherë?

Pohimi juaj:**Dëshmia juaj:****Arsyetimi juaj i dëshmisë:**

■ FORMULIMI I PYETJEVE SOKRATIKE

Formulimi i pyetjeve Sokratike është formë e formulimit të disiplinuar të pyetjeve që mund të përdoret për t'i ndihmuar nxënësit t'i eksplorojnë idetë e tyre, të nxjerrin të vërtetën nga gjërat, të zgjidhin çështje dhe probleme, të bëjnë supozime, të analizojnë koncepte, të dinë dallimin midis asaj që dimë dhe nuk dimë, të ndjekin pasojat logjike të mendimit ose të kontrollojnë diskutimet.

Në mësimdhënie, mësuesit mund t'i përdorin pyetjet Sokratike për të paktën tri qëllime:

- Për të hetuar thellësisht të menduarit e nxënësit, për t'i ndihmuar nxënësit që të bëjnë dallimin midis asaj që dinë ose kuptojnë nga ajo që nuk dinë ose nuk kuptojnë (dhe për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë virtytin intelektual).
- Për të nxitur aftësitë e nxënësve për të shtruar pyetje Sokratike, për t'i ndihmuar nxënësit të mësojnë mjetet e fuqishme të dialogut Sokratik, në mënyrë që ata të mund t'i përdorin këto mjete në jetën e përditshme (kur i bëjnë pyetje vetes dhe të tjerëve).
- Për t'i mësuar drejtpërdrejt nxënësve si të ndërtojnë dhe shtrojnë pyetje të thella. Përtej kësaj, nxënësve iu duhet praktikë për t'i përmirësuar aftësitë e tyre të shtrimit të pyetjeve.

Shtrimi i pyetjeve Sokratike është thelbi i mendimit kritik.

Shtrojeni pyetje grupit dhe kërkoni nga ata të diskutojnë se si mund t'i përdorin në një klasë dhe pse?

1. Pyetjet për sqarim: Nxitja e nxënësve për të sqaruar të menduarit e tyre dhe për të eksploruar origjinën e të menduarit të tyre.	• Pse e thoni këtë? • A mund ta shpjegoni më tej? • Si lidhet kjo me diskutimin tonë? • “A do ta përfshini difuzionin në ekuacionet tuaja të moleve?”
2. Pyetjet që hetojnë supozimet: Sfidimi i nxënësve për supozimet.	• A ndodh gjithmonë kështu? • Pse mendon se ky supozim e ka bazën këtu? • Çfarë tjetër mund të supozojmë? • Si mund ta verifikojmë ose kundërshtojmë këtë supozim? • “Pse po e neglizhoni difuzionin radial dhe po e përfshini vetëm difuzionin aksial?”
3. Pyetjet që hetojnë arsye dhe dëshmi: Ofrimi i dëshmive si bazë për argumente.	• A ka arsye për ta vënë në dyshim këtë dëshmi? • Çfarë shembulli mund të marrim? • Çfarë është....e ngjashme me? • Çfarë mendoni cilat janë shkaqet që e bëjnë... të ndodhë? Pse? • “A mendoni se difuzioni është përgjegjës për konvertimin e ulët?”
4. Pyetje për këndvështrimet dhe perspektivat: Zbulimi i këndvështrimeve, perspektivave alternative dhe konflikteve në mes pohimeve.	• Cila do të ishte alternativa? • Në çfarë mënyre tjetër mund ta shohim këtë çështje? • A mund ta shpjegoni pse kjo është e nevojshme ose me dobi, dhe kush përfiton? • Pse... është më e mira? • Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të...? • Si ngjasojnë...dhe ...? • Cili është kundër argumenti për...? • “Me gjitha lakimet në gyp, nga këndvështrimi industrial/praktik, a mendoni se difuzioni do të ketë ndikim në konvertim?”
5. Pyetjet që hetojnë implikime dhe pasoja:	• Çfarë përgjithësime mund të bëni? • Cilat janë pasojat e këtij supozimi? • Çfarë po nënkuptoni? • Si ndikon...në...? • Si lidhet...me atë që kemi mësuar më parë? • “Si do të ndikoheshin rezultatet tona nëse do ta neglizhonim difuzionin?”
6. Pyetjet për pyetjen:	• Cili ishte qëllimi i kësaj pyetje? • Pse mendoni se e shtrova këtë pyetje? • Çfarë do të thotë...? • Si aplikohet...në jetën e përditshme? • “Pse mendoni se difuzioni është i rëndësishëm?” “

SESIONI 2: DËSHMITË – PJESA 2

■ FAKTET E PAVËRTETA

Filloni me videon: “How not to be ignorant about the world” (Si të mos jemi injorantë për botën), nga Hans Rosling dhe Ola Rosling. (Shënim për lehtësuesit — Titullin mund ta gjeni në 28 gjuhë).

Ndërpriteni videon pas secilës pyetje që shtron Rosling-u në fillim dhe kërkojini pjesëmarrësve të përgjigjen. Vazhdoni me videon.



https://www.ted.com/talks/hans_and_ola_rosling_how_not_to_be_ignorant_about_the_world?language=en

Kërkojini pjesëmarrësve të diskutojnë në grupe të vogla se çfarë përfundimesh mund të nxjerrin nga videoja? Pse janë të rëndësishme dëshmitë dhe si duhet t'i përdorim ato.

■ MEDIA

Analizimi i tekstit informues

Tema/titulli: Për çfarë flet teksti? A i përmbledh titulli gjërat më të rëndësishme në tekst? A do ta ndryshonit dhe si do ta ndryshonit titullin?

Qëllimi: Cili është qëllimi i përgjithshëm: përgjigja e një pyetjeje, paraqitja e një problemi, informimi, argëtimi, bindja? Si e dini?

Autorët: Kush është autori/ët i tekstit? Çfarë i kualifikon ata të shkruajnë për këtë temë?

Pozicionimi: A është i qartë opinioni i autorëve apo informacioni është prezantuar si “objektiv”? A janë dhënë edhe këndvështrime të tjera?

Dëshmia: Çfarë lloj dëshmie, nëse ka, është përdorur për t'i mbrojtur konkluzionet ose idetë themelore në tekst?

■ REKLAMA E BAZUAR NË DËSHMI

Bëni një reklamë televizive, e cila do të bazohet në dëshmi.

SKENARI:


SESIONI 3: PERSPEKTIVAT E NDRYSHME

Rezultatet e të nxënit

Pjesëmarrësit do të:

- përgatitin argumente dhe marrin pjesë në debat
- analizojnë një problem dhe/ose çështje nga një perspektivë tjetër
- arrijnë kompromis për të marrë vendim.

■ PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË SHQYRTOJMË NJË PERSPEKTIVË TJETËR?



Fabula e të verbërve dhe një elefanti e ka origjinë nga kontinenti i vjetër indian, nga ku u shpërnda në mbarë botën. Është tregimi i një grupi të të verbërve, që asnjëherë më parë nuk kishin hasur një elefant dhe të cilët mësojnë dhe formojnë një ide në mendje se si është një elefant duke e prekur atë. Secili nga të verbërit e prek dhe ndjen një pjesë të trupit të elefantit, por vetëm një pjesë të tij, si është pjesa anësore ose dhëmbi. Pastaj ata e përshkruajnë elefantin bazuar në përvojën e tyre të kufizuar dhe përshkrimet e tyre për elefantin janë të ndryshme nga njëri-tjetri. Në disa versione, ata madje dyshojnë se personi tjetër nuk po tregohet i sinqertë dhe nisin të grinden. Morali i fabulës është se njerëzit kanë tendencë të kërkojnë të vërtetën absolute bazuar në përvojën e tyre të limituar dhe subjektive, përderisa i injorojnë përvojat e limituara dhe subjektive të personave të tjerë, të cilat mund të jenë po ashtu të vërteta.¹⁰

ÇFARË ËSHTË PERSPEKTIVA?

Perspektiva është pikëpamje: mënyra si dikush e sheh një situatë, çfarë ndjen për një situatë dhe në fund opinionet e tyre për një situatë. Theksoni se gjithmonë ka së paku dy anë të tregimit; prandaj njerëzit i drejtohen gjykatës dhe mësuesit e pyesin secilin nxënës të përfshirë në mosmarrëveshje që ta tregojë anën e tij ose të saj të ngjarjes.

¹⁰ E. Bruce Goldstein (2010). Encyclopedia of Perception.. [Enciklopedia e perceptimit]. SAGE Publications. p. 492. ISBN 978-1-4129-4081-8

■ DEBATI I SHKOLLËS

Çështje të diskutueshme:

Unë jam (perspektiva):

Pozicioni ynë (pohimet, dëshmitë, arsyetimi):

Rregullat bazë:

- Duhet ta dëgjojmë me durim njëri-tjetrin për t'i kuptuar perspektivat e ndryshme
- Qëllimi ynë është të gjejmë një zgjidhje, jo të fitojmë betejën
- Do t'i përgjigjemi pretendimit dhe do ta argumentojmë
- Do të tregojmë respekt dhe të jemi miqësor.

Vëzhgoni dhe merrni shënim për argumente të ndryshme.

Roli i pjesëmarrësit:	Argumenti i prezantuar:
	Dëshmia:
Pajtoheni/ Nuk pajtoheni	Shpjegoni pozicionin tuaj – kundër argumentet:

Roli i pjesëmarrësit:	Argumenti i prezantuar:
	Dëshmia:
Pajtoheni/ Nuk pajtoheni	Shpjegoni pozicionin tuaj – kundër argumentet:

SESIONI 4: STRATEGJITË DHE MJETET E MËSIMDHËNIES

Rezultatet e të nxënit

Pjesëmarrësit do të:

- përdorin Gjashtë kapelat për të menduar (Six Thinking Hats) për të analizuar perspektiva të ndryshme në zgjidhjen e problemeve
- përdorin Pemën e problemit për të identifikuar shkaqet dhe pasojat.

■ GJASHTË KAPELET PËR TË MENDUAR

Gjashtë kapelet për të menduar është sistem i dizajnuar nga Edward de Bono i cili përshkruan një mjet për diskutimin në grup dhe të menduarit individual duke përfshirë gjashtë kapele me ngjyra. “Gjashtë kapelet për të menduar” dhe ideja e ndërlidhur e mendimit paralel ofrojnë mjete për grupet, në mënyrë që ata t’i planifikojnë proceset e të menduarit në mënyrë të detajuar dhe logjike, dhe duke e bërë këtë, të mendojnë së bashku në mënyrë më efektive. Qasja e Gjashtë kapeleve për të menduar mund të përdoret për të adresuar pothuajse çdo aktivitet të zgjidhjes problemore që mund të hasni në klasë.


	Kapelja e bardhë kërkon informacionet e ditura ose të nevojshme. “Faktet, vetëm faktet.” Lini mënjane argumentet dhe propozimet dhe shikoni bazën e të dhënave. Kjo mbulon faktet, shifrat, nevojat dhe mungesat e informacioneve. Shikoni informacionet që keni dhe shikoni çfarë mund të mësoni nga ato. Shikoni çfarë nuk dini dhe plotësojini ose merrini parasysh.
	Kapelja e verdhë është simbol i pozitivitetit dhe optimizmit. Nën këtë kapelë ju eksploroni gjërat pozitive dhe shikoni cilat janë vlerat dhe dobietë. Kapela e verdhë ju ndihmon të mendoni pozitivisht. Është këndvështrimi optimist që ju ndihmon të shihni të gjitha përfitimet e vendimit dhe vlerën në të. Pse diçka do të funksionojë dhe pse do të sjellë përfitime. Mund të përdoret teksa presim rezultatet e disa veprimeve të propozuara, por mund të përdoret edhe për të gjetur diçka me vlerë në atë që tashmë ka ndodhur. Mendimi me kapelën e verdhë ju ndihmon të vazhdoni para kur gjërat duken të zymta dhe të vështira..
	Kapelja e zezë simbolizon gjykimin - avokatin e djallit ose shtjellon pse diçka mund të mos funksionojë. Nxjerr në pah vështirësitë dhe rreziqet; ku gjërat mund të shkojnë keq. Ndoshta kjo është Kapela më e fuqishme dhe e dobishme në mesin e Kapelave por që paraqet problem nëse përdoret me tepri. Duke përdorur kapelën e zezë për të menduar, shikoni të gjitha pikat e këqija të vendimit. Shikoni me kujdes dhe me vëmendje. Mundohuni të shihni pse mund të mos funksionojë. Kjo është e rëndësishme sepse thekson anët e dobëta të një plani. Ju mundëson t'i eliminoni, ndryshoni ato ose të përgatitni plane emergjente për luftimin e tyre. Nuk ka kuptimin e një kapele inferiore ose negative. Kapela e zezë përdoret për të vërejtur se pse një sugjerim nuk përkon me faktet, përvojën e disponueshme, sistemin në përdorim ose politikën që ndiqet. Kapela e zezë duhet të jetë gjithmonë logjike. Mendimi nën kapelën e zezë ju ndihmon që planet tuaja të jenë ‘më të fuqishme’ dhe më të qëndrueshme. Mund t’ju ndihmojë edhe të vëreni të metat fatale dhe risqet para se të filloni një veprim.
	Kapelja e kuqe ka kuptimin e ndjenjave, parandjenjave dhe intuitës. Kur e përdorni këtë kapelë ju mund të shprehni emocione dhe ndjenja dhe të ndani frikën, pëlqimet, mospëlqimet, çfarë doni dhe urreni. ‘Kur vini’ kapelen e kuqe, ju i shikoni problemet duke përdorur intuitën tuaj, reagimin instinktiv dhe emocionet. Gjithashtu mundohuni të kuptoni si do të reagojnë emocionalisht të tjerët. Mundohuni të kuptoni përgjigjet e personave që nuk e njohin plotësisht arsyetimin tuaj. Kapela e kuqe i lejon mendimtarit të shprehë intuitë pa pasur nevojë ta arsyetojë atë. Zakonisht ndjenjat dhe intuata mund të futen në diskutim nëse mbështeten në logjikë. Nganjëherë ndodh që ndjenja është e vërtetë por logjika është e rremë. Kapela e kuqe i jep mendimtarit lejen e plotë për të shprehur ndjenjat e tij ose të saj për temën në atë moment.
	Kapelja e gjelbër fokusohet në kreativitet, mundësi, alternativa dhe ide të reja. Është mundësi për të shprehur koncepte dhe perceptime të reja.
	Kapelja e kaltër përdoret për menaxhimin e procesit të të menduarit. Është mekanizmi kontrollues që siguron që udhëzimet e Six Thinking Hats® po vëzhgohen.

¹¹ http://www.debonogroup.com/six_thinking_hats.php; <http://raising-teaching-children.blogspot.com/2013/10/six-thinking-hats-collaborative.html>

Gjashtë kapelet për të menduar mund të përdoren në mënyra të ndryshme në klasë:

- Ndani klasën në 5 grupe (ju mund ta mbani kapelën e kaltër) dhe kërkon nga secili grup që të analizojë problemin nga perspektiva e secilës kapelë
- Formoni grupe me 6 nxënës, ku secili prej tyre merr një kapele
- Nxënësit mund të ofrohen vullnetarë për një kapelë të caktuar nëse kanë ndonjë ide të mirë
- Mund t'i përdorni gjatë diskutimit në klasë – duke folur nga perspektiva e një kapele
- Mund t'i drejtoni diskutimet për një problem që ka ndodhur në klasë
- Mund t'i analizoni tema të ndryshme të lëndëve.

Bëni kubin dhe vendosni një kapele në çdo anë. Tregoni temën dhe nxënësit mund të rrokullisin zarin për të vendosur perspektivën.



Shembull:

Prezantoni çështjen (kapelja e kaltër): Vakti në shkollë ose tekstet shkollore janë falas për të gjithë fëmijët.

Prezantoni nga një kapelë dhe kërkon nga pjesëmarrësit të bëjnë pyetje nga perspektiva e asaj kapele, në pajtim me funksionin e saj.

Mendimi me kapelen e verdhë: Cilat janë përfitimet e ofrimit të vakteve falas?

Mendimi me kapelen e zezë: Çfarë do ta bënte të vështirë ofrimin e vakteve falas?

Mendimi me kapelen e gjelbër: Çfarë idesh keni për t'i zgjidhur problemet e kapelës së zezë?

Mendimi me kapelen e kuqe: Si ndiheni për këtë vendim? Kush do të ishte më i kënaquri?

Mendimi me kapelen e bardhë: Sa nxënës kemi? Sa do të kushtojë për secilin nxënësit?

Formoni grupe me nga pesë persona dhe secilit jepini nga një kapele të ndryshme.

■ PEMA E PROBLEMIT

Pema e problemit është metodë e paraqitjes së problemeve kryesore, bashkë me shkaqet dhe pasojat e tyre. I ndihmon fëmijët të mendojnë në mënyrë analitike dhe të gjejnë zgjidhjet e tyre për një problem. Theksi është në të kuptuarit e problemit si fillim.

Vizatoni pemën, me rrënjët dhe degët. Merrni një problem që është i njohur për pjesëmarrësit (ose nxënësit në klasë).

Për shembull (pjesëmarrësit): Prindërit nuk përfshihen në aktivitetet e shkollës/klasës (Tema opsionale: numër i madh i mungesave në shkollë, nota të ulëta në disa lëndë; nxënësit nuk lexojnë mjaftueshëm libra; obeziteti i fëmijëve).

Analiza e shkaqeve dhe pasojave duke përdorur pemën e problemit mund të përdoret për tema si: ndotja e lumenjve, shprehitë e të ngrënit jo shëndetshëm, prerja e pemëve, përdorimi i qeseve plastike, situata e problemit në një tregim ose libër etj.

Shënoni problemin në trungun e pemës.

Pyesni: Pse e kemi këtë problem?
Cilat janë shkaqet e këtij problemi?
Cilat janë efektet e këtij problemi?


Kërkoni nga pjesëmarrësit ta vizatojnë pemën në tabelë, diskutoni dhe shkruani të gjitha shkaqet dhe pasojat që ju vijnë ndër mend.

Inkurajoni pjesëmarrësit të mendojnë më thellë, duke i identifikuar shkaqet direkte dhe indirekte dhe pasojat afatshkurta dhe afatgjata.

Vendosini fletët tuaja në mure dhe bëni një shëtitje në galeri, duke i lexuar idetë e grupeve të tjera.

Reflektoni – Çfarë mësuat? A mund t'ju ndihmojë kjo për të dalë me zgjidhje?

Mendoni për përdorimin e këtij mjeti në klasë.



2.3 Dita e tretë

Dita e tretë ka të bëjë me reflektimin dhe aplikimin e njohurive. Në dy sesionet e para, pjesëmarrësit do të përdorin dhe thellojnë njohuritë e tyre për micro:bit-in. Dy sesionet e fundit ofrojnë kohë për planifikimin e aktiviteteve të klasës dhe projekteve shkollore.

Dita e tretë përbëhet nga katër sesione prej 90 minutash:

SESIONET

Sesioni 1: Karakteristikat dhe përdorimi i Micro:bitit

Sesioni 2: 2: Micro:bit-i – Pjesa 2

Sesioni 3: Çfarë mësuam?

Sesioni 4: Projekti i shkollës

SESIONI 1: MICRO:BIT-I

Rezultatet e të nxënit

Pjesëmarrësit do të:

- kuptojnë karakteristikat e micro:bit-i
- ndërlidhin përdorimin e micro:bit-it me lëndën e tyre
- identifikojnë ciklin e zgjidhjes problemore
- gjenerojnë ide për zgjidhjen e problemit duke përdorur micro:bit-in
- planifikojnë projektin e tyre të shkollës dhe aktivitetet e klasës.

KARAKTERISTIKAT

Së pari, kërkoni nga pjesëmarrësit të tregojnë se çfarë mbajnë mend nga trajnimi për micro:bit-in. Mos u habisni nëse disa prej tyre nuk kanë informacion për micro:bit-in. Tregojini atyre se si fillim do të luani lojën e karakteristikave.

Në tavolinë janë dy grupe kartash. Njëri grup ka të bëjë me karakteristikat e micro:bit-it dhe grupi tjetër i kartave ka të bëjë me gjërat konkrete/projektet/detyrat që mund t'i kryeni me micro:bit-in.

Kërkoni prej tyre që të ndërlidhin karakteristikën me detyrën konkrete. Ja si duhet të duket në fund. Është mirë që pjesëmarrësit të jenë të ndarë në grupe, në mënyrë që diskutimi të jetë më i gjallë. Si fillim, kërkoni që t'i lidhin karakteristikat me detyrat.

Grupi 1 – KARAKTERISTIKAT	Grupi 2 – JU LEJON
LED-ët Shkurtesa LED nënkupton Dioda Emetuese e Dritës. Micro:bit-i ka 25 LED-ë të programueshëm individualisht.	Shfaqjen e tekstit, numrave dhe imazheve.
SENSORI I DRITËS Duke i kthyer LED-ët për t'u shndërruar në input, ekrani i LED-it punon si sensor bazik i dritës.	Të detektoni dritën e mjedisit.
SENSORI I TEMPERATURËS Micro:bit-i funksionon si sensor bazik i temperaturës.	Të detektoni temperaturën e tanishme të pajisjes.
AKSELEROMETRI Akselerometri mat përshpejtimin e micro:bit-it tuaj; ky komponent e ndjen kur micro:bit-i lëviz.	Të detektoni përshpejtimin dhe veprimet e tjera, p.sh. dridhjen, pjerrësinë dhe rënien e lirë.
KOMPASI Kompasi detekton fushën magnetike të Tokës.	Të detektoni se në cilin drejtim shkon micro:bit-i.
RADIO Tri karakteristikat e radios ju mundësojnë të komunikoni me valë (pa tel) ndërmjet micro:bit-ëve.	T'u dërgoni mesazhe micro:bit-ëve të tjerë, të ndërtoni lojëra me disa lojtar, dhe shumë më shumë!
BLUETOOTH Antena BLE (Bluetooth Low Energy) i lejon micro:bit-it të dërgojë dhe pranojë sinjale të Bluetooth-it.	Kjo i mundëson micro:bit-it të komunikojë pa tela me kompjuterë personalë, telefona dhe tabletë; pra ju mund ta kontrolloni telefonin tuaj nga micro:bit-i juaj dhe të dërgoni kode në pajisjen tuaj nga telefoni juaj!
BUTONAT Në pjesën e përparme të micro:bit-it janë dy butona (butoni A dhe B).	Mund ta detektoni kur janë shtypur këta butona, duke iu lejuar të aktivizoni kodin në pajisje.
PINAT Gjithsej 25 konektorë të jashtëm janë në konektorin e micro:bit-it, të cilëve iu referohemi si 'pina'.	Të programoni motorët, LED-ët ose komponentët e tjerë elektrikë me pinat ose lidhni sensorë shtesë për ta kontrolluar kodin tuaj!

Pasi pjesëmarrësit t'i përfundojnë detyrat e tyre, kërkoni t'i prezantojnë gjetjet. Mund t'ju bëni disa pyetje të tjera si:

- A u befasuat nga disa prej karakteristikave?
- A keni ide si mund të përdoret në klasën tuaj?

■ PËRDORIMI I MICRO:BIT-it

Tani që ata i mësuat karakteristikat e micro:bit-it, le të luajmë një lojë tjetër. Nga grupi i karakteristikave, secili grup duhet të gjenerojë së paku 2 ide se si mund ta lidhni mikro:bit-in me klasën ose lëndën që jepni.

Nga grupi i karakteristikave, pjesëmarrësit duhet të marrin dy karta të rastësishme dhe nga ato të gjenerojnë një ide si si mund ta përdorin atë në klasë. Nëse e shihni se kjo është e vështirë për pjesëmarrësit në këtë fazë, lejoni të gjenerojnë ide nga dy kartat, edhe nëse ajo ide nuk mund të përdoret në klasë.

Për shembull, nëse pjesëmarrësit e marrin karakteristikën e **akseleratorit** dhe **radios**, ajo mund të përdoret për të numëruar hapat tuaj dhe i dërgon mesazh një micro:bit-i tjetër.

Lejoni pak kohë. Kërkoni nga pjesëmarrësit t'i prezantojnë gjetjet pasi të përfundojnë.

SESIONI 2: MICRO:BIT-i – PJESA 2

AKTIVITETI	STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES	BURIMET	KOHA
1. Ideja e kundërt	Pjesëmarrësit do ta zgjidhin problemin duke e përdorur micro:bit-in.		60'
2. Cikli i zgjidhjes problemore	Duke e përdorur ciklin e zgjidhjes problemore, pjesëmarrësit do ta planifikojnë aktivitetin e tyre të klasës.		

IDEJA E KUNDËRT

Problemi:

1. Jeni me pushime verore. Askush nuk është në shkollë. Disa bimë në shkollë do të vyshken nëse nuk ujiten.
2. Jeni duke mësuar të luani në piano. Në klasën tuaj nuk keni piano.
3. Veturat ecin shumë shpejt pranë shkollës suaj. Policia do të reagojë por ka nevojë për fakte.
4. Jeni i mërzitur.

Përdorni grupin e kartave për t'i kuptuar më mirë limitet dhe karakteristikat e Micro:bit-it.

Zgjidhjet:

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Pasi të përfundoni, kaloni së bashku nëpër ciklin e zgjidhjes problemore dhe mundohuni ta dekonstruktioni procesin në klasë. Mund të përdorni njërin nga shembujt e gjeneruar më herët në këtë sesion, ose ndonjë problem tjetër.

Cikli i zgjidhjes problemore:

- a. Paraqitni një problem dhe shtroni pyetje për ta kuptuar atë plotësisht; sigurohuni që nxënësit ta kuptojnë me të vërtetë se cili është problemi. I lini të eksplorojnë, mësojnë rreth tij, të pyesin të tjerët...
- b. Imagjinoni zgjidhjet e mundshme – ejani me ide pa i analizuar ose gjykuar ato.
- c. Përzgjidhni idetë dhe shtroni hipoteza – zgjidhni disa nga idetë më të mira dhe shkruani supozimet tuaja ose hipotezën – çka do të ndodhte nëse...
- d. Bëni një plan dhe analizoni probabilitetin e zgjidhjeve, mendoni për të gjithë hapat dhe detajet.
- e. Testoni prototipin tuaj.
- f. Përmirësoni atë nëse duhet.

SESIONI 3: REFLEKTIMI

Rezultatet e të nxënit

Pjesëmarrësit do të:

- reflektojnë për atë që mësojnë
- planifikojnë zbatimin e strategjive të mësimdhënies në klasën e tyre.

■ ÇFARË MËSUAM?

TEMA	UNË MËSOVA
1. Mjedisi i klasës për MKZP-në	
2. Pyetjet	
3. Dëshmitë	
4. Perspektivat e ndryshme	
5. Strategjitë për zgjidhjen problemore	
6. Micro:bit-i	

■ IDEJA IME

■ ZHVILLIMI PROFESIONAL

QËLLIMET E MIA

Do të provoj: _____

Do të doja të përmirësoj Aftësitë e mia në: _____

Në periudhën tjetër, do të punoj në: _____

MËSUESIT

Siç e kemi përmendur edhe më heret, përfitimi dhe përmirësimi i aftësive të MKZP-së kërkon kohë dhe përpjekje dhe ato duhet t'i praktikojmë në kontekstin e lëndës dhe temës përkatëse, në klasat dhe shkollat tona. Për t'i këmbyer idetë dhe përvojat tona dhe për të reflektuar për praktikën tonë, është e rëndësishme që të dokumentohen aktivitetet, strategjitë dhe metodat e mësimdhënies që ne i përdorim në klasat tona.

Vizita e parë mentoruese do të jetë mundësi për të këmbyer përpjekjet tona, sukseset, reagimet e nxënësve por edhe për të shtruar pyetje dhe për të mësuar nga mësuesit e tjerë.

Ju lutem, përdorni formularin online në vijim për të dokumentuar shembujt e aktiviteteve, në pajtim me temat e trajnimit, që lidhen me aftësitë e MKZP-së. Si dëshmi mund të përdorni planet tuaja mësimore, shembuj (ose foto) të punës së nxënësve, burimet e përdorura e të tjera.

TEMA	ÇFARË DUHET TË BËHET	DËSHMITË
Pyetjet	Mendoni dhe planifikoni me kujdes lloje të ndryshme pyetjesh që mund t'i shtroni nxënësve – mësojini atyre si të formulojnë pyetje të mira.	Shembuj të pyetjeve të përpiluara nga mësuesi, shembuj të pyetjeve të përpiluara nga nxënësit, aktiviteti me nxënësit.
Faktet dhe opinionet	Përgatitni aktivitet që do t'i ndihmojë nxënësit të bëjnë dallimin midis fakteve dhe opinioneve gjatë leximit, përshkrimit, shkrimit...	Shembuj të aktiviteteve me nxënësit. Shembuj të formulimeve të Fakteve dhe Opinioneve.
Pohimi, dëshmitë dhe arsyetimi	Kryeni eksperiment ose hulumtim – lejojini nxënësit të formulojnë pohimet e tyre, të mbledhin dëshmi të mjaftueshme dhe të arrijnë në përfundime logjike	Shembuj të aktiviteteve me nxënësit. Pohimi që është dashur ta dëshmojnë. Shembuj të dëshmimeve dhe arsyetimit.
Diskutimet dhe debatet	Organizoni diskutime dhe debate në klasë për tema të debatueshme– përcaktoni rregullat dhe përdorni argumente. Analizoni argumentet dhe arrini në dakordësi.	Temat e diskutimit dhe debatit. Shembuj të argumenteve të dhëna nga nxënësit. Përshkrimi dhe reflektimi për procesin.
Shqyrtimi i perspektivave të tjera	Ofroni mundësi që nxënësit të shqyrtojnë perspektiva të tjera gjatë shkrimit, analizimit, zgjidhjes së problemeve, vendim marrjes...	Shembuj të aktiviteteve me nxënësit.
Micro:bit-i dhe zgjidhja e problemeve	Përfshini nxënësit në zgjidhjen problemore duke përdorur micro:bit-in.	Problemi që atyre i është dashur ta zgjidhin dhe mënyra si e zgjidhin duke e përdorur micro:bit-in.

FORMULARI PËR DOKUMENTIMIN E PRAKTIKËS SË MËSIMDHËNIES

(përdorni aq formularë sa ju nevojiten në mënyrë që të përfshini të gjitha shkathtësitë e MKZP-së)

Vendi/Qyteti:		
Shkolla:		
Emri i mësuesit:		
Kontakti:		
Lënda:		
Klasa (mosha e nxënësve):		
Tema (fusha e lëndës):		
Rezultatet e të nxënit:		
Shembulli përfshin:		
	PYETJET E NIVELIT TË LARTË	
	FAKTET DHE OPINIONET	
	POHIMI, DËSHMITË DHE ARSYETIMI	
	DISKUTIMET DHE DEBATET	
	SHQYRTIMI I PERSPEKTIVAVE TË TJERA	
	MICRO:BIT-i DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE	
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:		
Shtojcat (planet, fotot, videot...):		

SESIONI 4: PLANIFIKIMI I PROJEKTIT TË SHKOLLËS

Pas përfundimit të trajnimit, ekipi i shkollës, duke përfshirë drejtorin dhe mësuesit, duhet të planifikojë aktivitete të ndryshme me qëllim që:

- Të prezantojë aftësitë e përfituara, njohuritë dhe burimet para pjesëtarëve të tjerë të stafit të shkollës, por edhe para prindërve dhe nxënësve
- T'i përfshijë ata në projektin/et e shkollës, që kanë për synim përmirësimin e aftësive të MKZP-së dhe përdorimin e micro:bit-it në nivel të shkollës

Hapi i parë duhet të përfshijë procesin e planifikimit, përcaktimin e qëllimeve, rezultate të nxënive dhe rezultateve të pritshme, për të vazhduar me planin e hollësishëm të veprimit me përgjegjësitë, afatet kohore dhe burimet.

Nxënia përmes projekteve iu jep nxënësve mundësi për të punuar së bashku në projekte afatgjate që kanë kuptim. Studimet kanë dëshmuar se nxënia përmes projekteve mund të çojë në rritje të mendimit kritik, rritje të besimit në nxënie, aftësi për të përkufizuar probleme, arsyetim me argumente të qarta dhe zotërim të përmbajtjes. Ndryshimet pozitive për mësuesit dhe nxënësit përfshijnë më shumë motivim, përmirësim të qëndrimit ndaj të nxënësve dhe aftësive, shprehje të punës dhe aftësi të zgjidhjes së problemeve. Nxënësit që kanë vështirësi në të nxënës tradicional mund të shkëlqejnë në të nxënës përmes projekteve.

Projektet ndërdisiplinore u lejojnë nxënësve të kuptojnë se përmbajtja e lëndës në të vërtetë nuk është e ndarë nga bota reale. Përkundrazi, të gjithë i përdorin njohuritë e përmbajtjes të gërshtuara për të zgjidhur një problem ose detyrë gjatë ditës.

■ HAPAT NË PLANIFIKIMIN E PROJEKTIT

Në grupet e shkollës gjeneroni ide për një ose dy projekte (pavarësisht nga madhësia e shkollës).

Hapi 1: Zhvilloni një temë që zgjon interesim dhe që e mbulon përmbajtjen dhe rezultatet e kurrikulës, që ka lidhje të vërtetë me ndonjë problem të shkollës, komunitetit lokal ose të jetës reale, dhe jepni mundësi nxënësve të përdorin aftësitë e MKZP-së dhe micro:bit-in për të marrë pjesë, eksploruar dhe kryer hulumtimin.


Disa nga idetë mund të përfshijnë:

- Si të themelohet një klub i micro:bit-it?
- Si të përmirësohet mjedisi i nxënies në shkollë – hapësira fizike (riorganizimi i klasës)?
- Si ta mbështesin komunitetin e tyre?
- Si të përmirësohet të nxënës mes shokëve?

Por edhe në lidhje me përmbajtjen:

- Si të bëhemi shkollë më e “gjelbër”?
- Ushqimi i shëndetshëm – përmirësimi i shprehjeve të të ngrënies
- Komuniteti ynë – më parë, tani dhe në të ardhmen
- Mësoni si të kurseni – burimet, paratë, mjedisin.

Idetë tona:




Shtroni pyetjet në vijim:

- A mund t'i përfshini nxënësit në planifikimin, vendim marrjen, organizimin dhe zbatimin e projektit?
- Si do t'i përfshini Aftësitë e MKZP-së dhe micro:bit-t?
- Cilët mësues të tjerë ose pjesëtarë nga stafi i shkollës mund ta përfshini?
- Cilët pjesëtarë të komunitetit mund të përfshihen?

Zhvilloni një hartë mendore të ngjashme me atë në fillim të trajnimit, por këtë herë harta duhet të mendohet dhe organizohet rreth temave të ndryshme – studimeve sociale, gjuhës, shkencës, artit... Identifikoni aktivitetet e mundshme dhe pyetjet kyçe të cilave duhet t'i përgjigjen nxënësit përmes të nxënimit dhe hulumtimit.

Hapi 2: Filloni duke e pasur në mendje si do të jetë fundi. Mendoni për produktet e ndryshme finale të projektit dhe mënyrat e prezantimit të tij para audiencave të ndryshme.

Hapi 3: Zhvilloni planin e veprimit me qëllimet, rezultatet, rolet, përgjegjësitë dhe afatin kohor.



Vlerësoni idenë tuaj të projektit:

QËLLIMI – PSE PO E BËJMË KËTË PROJEKT?			
Projekti bazohet në një problem të identifikuar që duam ta zgjidhim; një praktikë të cilën duam ta përmirësojmë ose një pyetje të cilës duam t'i japim përgjigje.			
Kemi qëllime dhe rezultate të nxëni të qarta dhe dimë si ta matim suksesin.			
ÇFARË PËRFSHIN PROJEKTI?			
Aktivitetet e projektit lidhen qartë me rezultatet e kurrikulës, duke u lejuar nxënësve të aplikojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre.			
Projekti përfshin mundësi për nxënësit që ta praktikojnë mendimin kritik, zgjidhjen problemore dhe përdorimin e micro:bit-it.			
Projekti është i lidhur me kontekstin e botës reale, përdorë procese dhe mjete të botës reale dhe ka ndikim të vërtetë.			
KUSH DUHET TË PËRFSHIHET?			
Projekti përfshin ekip ose ekupe të mësuesve, nxënësve dhe, nëse është e mundur, prindërve, ekspertëve dhe pjesëtarëve të tjerë të komunitetit.			
Nxënësit duhet të kenë mundësi të praktikojnë shkathtësitë e tyre për jetën përmes përfshirjes në planifikimin e projektit, zbatimin dhe vlerësimin e tij.			
SI PREZANTOHEN REZULTATET E PROJEKTIT?			
Projekti kërkon që nxënësit ta demonstrojnë atë që kanë mësuar duke e krijuar një produkt që u prezantohet ose u ofrohet nxënësve të tjerë dhe/ose personave të tjerë jashtë klasës.			
Projekti është vlerësuar nga nxënësit, mësuesit dhe palët e tjera të interesit, duke iu ndihmuar atyre të mësojnë nga reflektimi për të.			

FORMULARI PËR DOKUMENTIMIN E PROJEKTIT

Vendi/Qyteti:	
Shkolla:	
Kontakti:	
Titulli i projektit:	
Kohëzgjatja e projektit (fillimi/fundi):	
Qëllimi i projektit:	
Rezultate të nxënit:	
Nr. i mësuesve të përfshirë:	
Nr. i nxënësve të përfshirë:	
Lista e aktiviteteve:	
Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve që lidhen me shkathtësitë e MKZP-së:	
Aktivitetet me micro:bit-in:	
Rezultatet e projektit:	
Shtojcat (plani, fotot, videot...):	



@ British Council 2019

The British Council is United Kingdom's international organisation for cultural relations and educational opportunities.

www.britishcouncil.org